



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR  
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA  
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Zyra e Sekretarit të Përhershëm

Office of the Permanent Secretary

Kancelarija Stalnoe Sekretara

Përgjigje nga Inspektorati i MMPH-së, për Drejtorin e Inspektoratit-Prishtinë në bazë të reagimit të IQMQP-së të datës 01.10.2010 nr. 2219/10.

Inspektorati i MMPH – së ka shqyrtuar dokumentacionin e prezantuar nga Drejtoria e Inspektoratit të K. K. së Prishtinës me Nr. 2302/3 të dt.21. 10.2010, në bazë të kërkesës nga Inspektorati i MMPH-së me Nr. 2302/10 ,dt. 13.10.2010 për informata për objektin e ndërtimit nga pronari Mustaf Loxha Rr.” Hajrullah Abdullahu “ nr.33 Prishtinë , në bazë të ankesës nga IQMQP-së të datës 01.10.2010 me Nr.2219/10 .

Në bazë të fakteve të prezantuara nga Inspektorati i K. K. së Prishtinës ,për objektin e lartpërmendur, Inspektorati i MMPH-së konstaton si vijon :

Inspektorati i ndërtimit i K.K. së Prishtinës ka bërë shkelje të Ligjit të Ndërtimit Nr.2004/15 , sepse nuk ka zbatuar të gjitha masat e nevojshme konform ligjit nr.2004/15. Kjo vërehet shumë lehtë edhe nga vetë faktet e paraqitura të dokumentacionit .

Me dt.30.07.2010 kemi **Procesverbalin** nga inspektori i ndërtimit ku urdhërohet ndaj palës që ti ndërpres punët sepse ka tejkaluar Lejen Ndërtimore .Inspektorati i MMPH-së ka dërguar **Rekomandimin** me nr. 09/2192/5 të dt .09. 11.2009 , se në objektin e lartpërmendur ka shkelje ligjore dhe kemi kërkuar ndaj organeve përgjegjëse komunale të marinë të gjitha masat në kuadër të ligjit. Inspektorati i K.K. të Prishtinës me dt.05.11.2009 nxjerr **Akvendimin** nr.05 Nr.354-29777 , ndaj palës që ti **Pezulloj** punët ndërtimore në objekt sepse pala nuk ka respektuar Lejen Ndërtimore nr.351-13664. të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit të Prishtinës.

